



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

12.04.2017

**ZGJEDHJET STUDENTORE 2017 – NJOFTIM PUBLIK PËR
STUDENTËT**

Njoftohen Organizatat Studentore se listat e kandidatëve për zgjedhjet studentore për parlament dhe këshilla të studentëve mund të dorëzohen deri më 13.04.2017 në ora 14:00. Për paraqitjen e listës së kandidatëve duhet të shfrytëzoni formularin i cili është publikuar në ueb faqe të umib.net.

Lista e kandidatëve duhet të përmbajë të dhënat sikurse kërkohet në nenin 24 pika 2 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve kurse për kandidatët e nominuar duhet të ofrohen të dhënat sikurse kërkohet në nenin 25 pika 3 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve. Lista e kandidatëve e Organizatave Studentore duhet të përbëhet prej maksimum, sa dyfishi i mandateve të lejueshme që të zgjidhet një organ, në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet e studentëve. Kandidatët tepricë do të hiqen prej listës nga KQZ.

Në pajtim me Statutin e përkohshëm dhe Rregulloren për zgjedhjet e studentëve Parlamenti përbëhet nga 11 anëtarë kurse në bazë të numrit të studentëve me të drejtë vote Këshillat e studentëve nëpër fakultete do të kenë këtë numër të anëtarëve: FGJ – 5; FTU – 7; FIMK – 11; FJ – 5; FE – 5 dhe FEEd – 7 anëtarë.

Kandidatët e paraqitur në lista duhet të deklarojnë me nënshkrimin e tyre pajtueshmërinë me kandidaturën.

Gjatë përcaktimit të kandidatëve – hartimit të listave keni parasysh nëse kandidatët e propozuar nuk bien ndesh me nenin 3 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve.


Te dhënat e kandidateve në formular duhet të plotësohen me shkronja të mëdha, dhe për këtë të shfrytëzohet formulari në excel i përbashkët.

Lista e kandidatëve dërgohet edhe në formën elektronike në email adresën: ermira.sopa@umib.net

Me respekt,



Xhelal Smakiqi


Kryesues i KQZ